



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Kuvendi i Komunës Klinë

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

01Nr 06-42506 /23

Klinë, dt 20.12 /23

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur, më 30.06.2023, në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 16:00.

Mbledhjen e udhëhoqi Nënkyrytarja e komunës së Klinës, Marqe Tanushi-Selmanaj, e cila përshëndeti të gjithë anëtarët e KKSBB-së dhe prezantoi rendin e ditës:

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;*
- 2. Fatkeqësítë natyrore dhe fatkeqësítë e tjera, verifikimi për servisimin e aparatave të fikjes së zjarrit;*
- 3. Identifikimi i zonave të rrezikshme në trafik (ku ndodhin më shumë aksidente) si dhe përgatitja për pritjen e bashkatdhetarëve tanë, etj;*
- 4. Ruajtja dhe mbrojtja e ambientit, iniciativa që duhet ndërmarrë;*
- 5. Të ndryshme.*

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.*

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Besoj që e keni lexuar dhe sipas rregullores duhet të miratohet, nëse nuk ka dikush diçka, atëherë ju ftoj që ta ngrini dorën nëse e miratoni, faleminderit shumë!

Unë i kisha dy pyetje nga mbledhja e kaluar dhe i kam përgjigjet e njëjtë, sikurse jam përgjigjur edhe më herët për rrugën e Dresnikut. Kryetari ka bërë kërkesën në ministri dhe po e pret përgjigjen nga ata, përndryshe nëse nuk kemi përgjigje brenda një afati të shkurtër kohor, kjo iniciativë do të shkojë me kërkesë në Kuvend dhe në bazë të kërkesës së Kuvendit besoj që duhet me ndërmarr diçka, se me të vërtetë ajo pjesë sa i përket rrugës është edhe siç e thotë Josipi.

2. Fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, verifikimi për servisimin e aparateve të fikjes së zjarrit.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Të gjithë e dimë se fatkeqësitë natyrore mund të ndodhin dhe të paraqesin rrezik për qytetarët, dhe vetë fjala fatkeqësi natyrore na tregon se gjithçka nuk është në dorën tonë dhe shumë shpesh janë edhe vështirë të menaxhohen. Ne jemi koshient të rasteve të fundit të fatkeqësive natyrore që kanë shkaktuar dëme të mëdha materiale dhe disa të pa riparueshme, por, ngjarja e fundit që ndodhi në qytetin e Pejës na ka bërë që të mendojmë thellë, që fatkeqësitë natyrore mund të janë tragjike dhe të marrin jetë njerëzish, ku njëkohësisht shfrytëzoj rastin të shprehi ngushëllime!

Në nivelin lokal jemi duke u munduar që në aspektin e të reshurave të ndërmarrim masa dhe të rregullojmë problemet me shtretërit e lumenjve, kudo që ka probleme, ku pjesa më e madhe e jona e dimë se çfarë pasoja kemi pasur.

3. Identifikimi i zonave të rrezikshme në trafik (ku ndodhin më shumë aksidente) si dhe përgatitja për pritjen e bashkatdhatarëve tanë, etj.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Ne e dimë se sezona e verës është e mbushur me bashkatdhatarë që vijnë dhe vizitojnë familjarët, vendin e vet, ambientin e vet, tokat ku ata kanë lindur. Pjesa më e madhe dhe ne si komunë duhet të jemi gjithmonë të gatshëm t'i presim dhe të krijojmë kushte të sigurisë, që ata të janë sa më rehatshëm dhe sigurtë në komunën tonë, dhe urojmë që edhe ata të janë të kujdeshëm në vendin e tyre!

4. Ruajtja dhe mbrojtja e ambientit, iniciativa që duhet ndërmarrë.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Pikë tjetër e rëndësishme në këtë takim është edhe ruajtja e ambientit. Si temë, ndoshta shumica muajave të shtoni se çka i duhet si temë mbledhjes së KKSB-së, por të gjithë e dimë se një ambient i pasur është një jetë e shëndetshme dhe një ambient i papastër paraqet rrezik për qytetarët. Nëse një depo mbeturinash, aty ku grumbullohen vërvshime, jam shumë e sigurt se gjatë verës ato paraqesin një zonë kontaminimi infekSIONESH, mandej grumbullimi i qenve endacakë, që prapë paraqet shqetësim dhe rrezik për qytetarët e

Klinës, pra, të gjitha këto i takojnë këtij grupi të sigurisë që ne duhet të jemi shumë të kujdesshëm. Ne, nga institucionet që vijnë, pos komandantit që e përfaqëson, ne të tjerët kontribuojmë në aspektin e dhënies së ideve, në aspektin e menaxhimit e kontributit, përndryshe pjesa tjeter e sigurisë i takon Policisë, e jona është që bashkërisht të nxjerrim iniciativa. Dhe po besoj që në të ardhmen do të punojmë që temat që do të diskutohen në këtë takim, të vijnë edhe nga ju anëtarët e KKSBS-së, që të mos sillemi gjithmonë tek temat e njëjtë, por, të jepni edhe ju ndonjë temë si ide, diçka që keni shqetësim apo interesim.

5. Të ndryshme.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Sa i përket temës së fundit, ne, në planin e KKSBS-së e kemi paraparë që të bëhet një lloj fletëpalosje/fletushke, ku me anë të saj të dalë nga KKSBS nga të gjithë ne bashkë, t'i vetëdijesojmë qytetarët tanë për ruajtje dhe mbrojtje të ambientit. Nuk kemi ende asgjë konkrete, pos që kemi idenë për këtë fletushkë dhe nëse ju jeni të interesuar, ne e kishim organizuar një ditë, si të themi, një takim të jashtëzakonshëm (takim pune), të japim disa ide se çka mund të përbajë ajo fletushkë. Për pjesën tjeter do të shikoj dhe do të mundohem ta përfundojë me punëtorët e tjerë të Komunës dhe për formën e financimit besoj që do ta gjejmë një formë. Por, kisha dashur që bashkë me ju të dalë diçka e tillë që i sensibilizon qytetarët në mbrojtje dhe ruajtje të ambientit, që shkon në mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve tanë.

Fjalën po e kaloj te komandanti, Ragip Bytyqi, mandej në cilëndo pikë që ju keni diçka, e keni fjalën.

Komandanti, Ragip Bytyqi: Faleminderit, nënkyetare, përshëndetje për të gjithë ju e në veçanti për besimtarët myslimanë! Urime festa e Kurban Bajramit, shpresoj të gjitha festat të na gjejnë mirë dhe si kemi dëshirë me shëndet e të bashkuar!

Kisha filluar me çështjen e fatkeqësive natyrore te pika e dytë e rendit; në muajin qershor me inicimin e Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë dhe me përkrahjen e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, ne, kemi hartuar një projekt për parandalimin e dukurive të zjarrit, duke përfshirë komandantin e zjarrfikësve dhe gjithë personelin e zjarrfikësve të cilët e kanë realizuar një fushatë sensibilizuese mbi këto dukuri negative që na ndodhin në komunën tonë.

Sa i përket çështjes së sigurisë në muajin qershor, ne i kemi edhe statistikat gjashtëmuore të vitit 2023, deri më tanë me statistika dhe paraqitje të rastit jemi jashtëzakonisht të kënaqur, duke pasur parasysh se gjatë këtij muaji ka pasur ulje të incidenteve, ku ka vite që për një muaj nuk ka ndodhur të jenë 22 incidente është pak për çudi, ku ndoshta edhe rasti në veri ka shtuar ende më shumë patrullat e Policisë dhe ndoshta kjo e ka dhënë efektin e vet në parandalimin e incidenteve. Dmth zbulueshmëria e këtyre 22 rasteve është diku 85%, kemi pasur 20 aksidente të paraqitura; 4 prej tyre janë me lëndime; 16 janë n... ne materiale; janë shqiptuar 572 gjoba; janë arrestuar 15 persona. Ky muaj na ka karakterizuar me një numër të vogël të incidenteve, ku kemi pasur kohë më tepër të punojmë në hetime dërejë parandalime të rasteve. Ditëve të fundit, jeni në dijeni për një rast në Gjakovë që na ka goditur të gjithëve, ku një person i mundshëm që e ka kryer atë vepër është arrestuar në zonën tonë të përgjithësisë, dje besoj që e keni parë, kemi

kërkuar ndihmë edhe përmes mediave. Është edhe një person tjetër i kërkuar nga zona jonë e përgjithësisë dhe shfrytëzoj rastin që këtu t'ju them se ata që kanë ndonjë informacion të na ndihmojnë në informata deri në arrestimin edhe të atij personi, që të ndriçohet ai rast i rëndë. Kaq ishte nga ana ime, nëse ka dikush ndonjë pyetje, urdhëroni?

Z. Elmi Zenunaj: Faleminderit, kryesuese! Unë me sinqeritetin më të madh e falënderoj Policinë e Kosovës për iniciativën e parandalimit të zjarrit, iniciativë e cila është dashur të burojë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente, që sipas programit që kemi ne si drejtori prej vitit 2003 kemi sektorin e preventives, sektorin e parandalimit, sektorin e planifikimit të alarmuar dhe secili zyrtar e ka pasur rëndësinë e vet dhe është dashur të fuqizohet dhe plotësohet me staf përcjellës. Por, sot, nuk e kemi asnjë sektor që funksionon në kuadër të ekzekutivit të Komunës së Klinës, vitet e kaluara, zyrtarja e preventives ose sektori i parandalimit ka marr shumë iniciativa të tillë që ka marr tash Policia, por, tani e kisha falënderuar në mënyrë të veçantë Policinë për iniciativën e marrë, për të marr masa që të mos vijmë deri te fatkeqësitë e rënda natyrore. Zyrtari i planifikimit që ka qenë, Ibish Raci, ka dalë në pension dhe prej asaj kohe nuk është zëvendësuar sektori i tij dhe është shumë më lehtësuese për ne si shërbim i zjarrfikësve dhe Policinë, ta kemi një plan të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore ose edhe nga zjarret. Me kënaqësinë më të madhe e kemi mbështetur Policinë e Kosovës, nuk e di a është në nivel të Kosovës kjo iniciativë apo nivel regional apo komunal, megjithatë, nuk kemi hezituar por i kemi mbështetur maksimalisht, faleminderit!

Komandanti, Ragip Bytyqi: Pas kërkesës që është bërë në nivelin e Drejtorisë Rajonale është aprovuar në nivelin e Drejtorisë Rajonale, është dërguar në Drejtorinë e Preventives, në Drejtorinë e Policisë, dhe ky projekt me asistimin tonë për nivel rajonal është aprovuar dhe është shpërndarë në gjithë Kosovën, dmth është projekt nacional.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Atëherë, unë besoj shumë që Drejtoria e Shërbimeve Publike, me siguri që e ka planin e veprimit për mbrojte nga fatkeqësitë, sepse kështu edhe funksionon ajo Drejtori. Mirëpo për detaje dhe planin e punës për këtë zyrtar nuk kam informata dhe nuk e di se si ka qenë forma e zëvendësimit të tij ose se a do të zëvendësohet, por e di qe në këto raste, kjo Drejtori me eficiencë shumë të madhe dhe gatishmëri, ju ka dalë zot qytetarëve, e them me kompetencë të plotë.

Komandanti, Ragip Bytyqi: Sa për informacion, vitin e kaluar i kemi filluar disa procedura bashkë me kryetarin e Komunës, për të na dhuruar një donacion prej Kuvendit Komunal. Prej bashkëpunimit të mirëfilltë që e kemi me të gjitha drejtoritë dhe nga Asambleja Komunale është marr një vendim për ndarjen e subvencioneve për stacionin Policor, diku rrëth 20 000 euro, dhe Kuvendi Komunal i ka ushtruar të gjitha ato veprimet e veta për hapjen e procedurave tenderuese dhe na kanë siguruar disa kompjuter, aparate profesionale për fotografimin e dëshmive në vendin e ngjarjes, jemi furnizuar me një dron jashtëzakonisht, disa kamera të cilat na nevojiten për punët tona hetimore dhe ky është një donacion që është e na ndihmon jashtëzakonisht shumë në të ardhmen. Kryetari, bashkë me stafin dhe duke i falënderuar edhe asamblistët e Kuvendit Komunal e kanë bërë një ndihmë jashtëzakonisht të madhe për stacionin tonë, që shfrytëzoj

rastin në emër të gjithë stafit komandues të stacionit Policor Pejë dhe stafit menaxhues të Drejtorisë Rajonale të Policisë në Pejë, i falënderoj jashtëzakonisht shumë!

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Nga kjo shihet interesimi i madh i kryetarit për sigurinë e vendit tonë, duke u munduar të mbështes çdo aktivitet të çdo institucioni që shkon në dobinë dhe sigurinë e çdo qytetari dhe si Komunë jemi të lumtur që kanë me shërbye për punë të mira.

Hoxhë, Fitim Bojaj: Përshëndetje për të gjithë dhe shfrytëzoj rastin t'ju uroj për festën e Kurban Bajramit! Po mendoj pasi i kemi edhe zgjarrfikësit këtu, që së bashku me Drejtoren e Shërbimeve Publike dhe Ambientit, që çdo mbrëmje të pastrohen rrugët e qytetit të Klinës, për arsy se ka shumë pluhur, dhe mendoj që pastërtia është mbi të gjitha.

Z.Elmi Zenunaj: Zgjarrfikësit e kanë të ndaluar të merren me këtë çështje, përpos ndonjë rasti të veçantë, është kompania "Hidro Drini" sepse ne s'jemi kompani pastruese, por jemi kompani e sigurimit të jetës së njerëzve.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, hoxhë! Kërkesa e jote ka një adresë tjetër që unë do ta përcjelli në vedin e duhur dhe uroj shumë për të mirën tonë të realizohet!

Komandanti, Ragip Bytyqi: Unë kisha propozuar që me pasur një përkrahje nga qytetarët, dhe nuk e di a ekziston mundësia për ta hartuar një rregullore, që përpos pjesëtarëve të zgjarrfikësve që janë aktiv, me filluar me i identifikuar edhe disa të rinj të cilët në mënyrë vullnetare mund të ndihmojnë kur ka nevojë, sepse ka raste kur ju veproni me orar shumë të gjatë dhe nuk ktheheni në familjet e juaja, por, sigurisht gjithmonë duke u mbështetur në aspektin ligjor.

Z.Elmi Zenunaj: Në vitet 2003-2004 e kemi marr këtë iniciativë, i kemi latur të gjitha fshatrat e Klinës, sidomos bashkësítë lokale dhe nuk kemi hasur përkrahje, për shkak se fjala e tyre e parë ishte "kush na paguan ne", dhe kjo është problem në nivel të Republikës.

Zv. Kryesuesja, znj. Marqe Selmanaj: Mirë, atëherë faleminderit shumë, për fund unë ju bashkangjitem urimit përfesten, begati e shëndet paçi gjithmonë!

Shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësja,
Orgeta Sylaj

Zv. Kryesuesja
Marqe Selmanaj

